VENDIM
Nr. 11, datë 20.10.2021

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT NGA KANDIDATI PËR ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR POZICIONE DREJTUESE TË MBAJTURA NË PARTI POLITIKE GJATË 10 VITEVE TË FUNDIT NGA DATA E KANDIDIMIT PËR VITIN 2021

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", dhe të germës "c" të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi:

VENDOSI:

1. Miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, për vitin 2021, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim ka efekt dhe fuqi juridike të përkohshme dhe do të zbatohet deri më 31.12.2021.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: **Ervin Pupe**

Anëtarë: **Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Adnan Xholi, Rilinda Selimi, Elona Toro, Gjon Fusha, Genti Xholi**

Lidhja nr. 1

FORMULAR VETËDEKLARIMI

POZICIONET DREJTUESE TË MBAJTURA NË PARTI POLITIKE NGA KANDIDATI PËR ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË 10 VITEVE TË FUNDIT NGA DATA E KANDIDIMIT PËR VITIN 2021

(Plotësohet nga kandidati që konkurron për anëtar të Gjykatës Kushtetuese në zbatim të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*")

I. Të dhënat e kandidatit që konkurron për anëtar të Gjykatës Kushtetuese:

Gjeneralitet

Emri	
Atësia	
Mbiemri	
Datëlindja	
Numri ID	

II. A keni mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit? (*Vendosni shenjën* X *përbri përgjigjes*)

PO ☐ / JO ☐

(*Nëse përgjigjeni* PO, *tregoni pozicionin drejtues që keni mbajtur, si dhe datën në të cilën keni ndërprerë ushtrimin e pozicionit drejtues*):

_____

_____

(**Shënim**: Për qëllime të ligjit, "*pozicion drejtues në parti*", konsiderohen strukturat hierarkike më të larta, monokratike apo kolegjiale, me natyrë vendimmarrëse dhe udhëheqëse në drejtim të hartimit, miratimit dhe zbatimit të qëllimeve dhe objektivave politike të partisë përkatëse, ku përfshihen por pa u kufizuar, rastet si vijon:

a) kryetar / kryetar nderi i partisë;
b) sekretar i përgjithshëm i partisë;
c) anëtar i kryesisë së partisë apo i një strukture ekuivalente.
d) anëtar i këshillit drejtues apo strukture ekuivalente;

e) sekretar për një fushë të caktuar;
f) kryetar i një dege të partisë në rreth;
g) sekretar i një dege të partisë në rreth;
h) çdo funksionar tjetër i cili kryen një detyrë apo mban një post që konsiderohet pozicion drejtues sipas statutit të partisë.

Unë, i/e nënshkruari/a _____, me nënshkrimin e këtij formulari konfirmoj nën përgjegjësinë time ligjore saktësinë e të dhënave të pasqyruara këtu dhe jam i vetëdijshëm se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular mund të pasjellë si pasojë skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.

Datë ___/____/_____

_____

(emër, mbiemër, nënshkrimi)